



UNIVERSITETI I PRIZRENIT "UKSHIN HOTI"
UNIVERSITY OF PRIZREN "UKSHIN HOTI"
Rruga e Shkronjave Nr.1, 20000 Prizren-Kosovë; Tel: + 381(0) 29-232 140;
Homepage: www.uni-prizren.com

Programi - Juridik

PROGRAMI MËSIMOR - SYLLABUS							
Niveli i studimeve		Bachelor	Programi	Juridik	Viti akademik	2015/16	
LËNDA		E DREJTA ROMAKE					
Viti	Parë	Statusi i lëndës	O	Kodi		ECTS kredi	
Semestri	Dytë					3	7
Javët mësimore		15		Orët mësimore 45		Ligjerata	Ushtrime
						3	2
Metodologjia e mësimin		Ligjërata, ushtrime, punime seminarike, konsultime, teste.					
Konsultime		Një orë para ligjeratave					
Mësimdhënësi		Dr.Iur.Muharrem Faiku		e-mail	Muharem.faiku@uni-prizren.com		
				Tel.	049147279		
Asistenti		Ma.sc.Fatmir Halili		e-mail	fatmir.halili@hotmail.com		
				Tel.			

Qëllimi studimor i lëndës	Përfitimet e studentit
<ul style="list-style-type: none"> • fitimi i njohurive lidhur me procesin e krijimit, evoluimit dhe ndryshimeve në institucionet dhe normat e së drejtës romake nën veprimin e rrethanave të ndryshme historike; • kuptimi i vazhdueshmërisë së traditës juridike të Evropës kontinentale dhe teorisë juridike; <ul style="list-style-type: none"> • nxjerrja e përfundimeve të përgjithshme lidhur me rolin dhe ndikimin e së drejtës në zhvillimin historik të shtetit romak; • afrimi i studentëve me terminologjinë juridike e cila edhe sot është aktuale; • njohja me ndikimin e së drejtës romake në të drejtën bashkëkohore të shteteve evropiane, e cila është ndërtuar mbi konceptet dhe normat e së drejtës romake, nëpërmjet pranimit të drejtpërdrejtë ose përmes teorisë baza e së cilës u zhvillua nga mësimi i së drejtës romake nëpër universitete; • njohja me teknikat e punës së juristëve romak, të cilat paraqesin model me vlera të përhershme kur është fjala për funksionimin praktik të së drejtës dhe përshtatjes së saj nevojave shoqërore. 	<p>E drejta romake është një nga disiplinat tradicionale hyrëse në fakultetet juridike në Evropë, e cila ka për qëllim që studentët t'i pajisë me dituri të domosdoshme për bazën e përbashkët të sistemeve juridike të Evropës kontinentale. Meqenëse zbatimi praktik i saj ka mbaruar, e drejta romake ka fituar karakterin e disiplinës juridiko-historike me një përmbajtje afërsisht të unisuar në shumicën e fakulteteve juridike të universiteteve evropiane. Bërthamën e lëndës e përbën materia e cila është prezantuar në institucionet e Justinianit dhe përfshin të drejtën private romake në kuptimin e saj më të gjerë (përveç të drejtës pronësore përfshinë edhe të dhënat elementare lidhur me të drejtën statusore dhe familjen). Përmes kësaj lënde synohet që të kuptohen parimet dhe mekanizmat e së drejtës romake. Studimi i saj përqendrohet në krijimin e koncepteve kryesore të së drejtës civile, zhvillimin e mendimit juridik, dhe mjeteve përmes të cilave e drejta është zbatuar në jetën e përditshme. Për më tepër, si hyrje e cila është e domosdoshme për të kuptuar rrethanat në të cilat janë krijuar dhe zhvilluar institutet e së drejtës romake, disiplina e sotme mësimore përmban edhe informata themelore lidhur me zhvillimin e shtetit romak, strukturën shoqërore dhe ekonomike, si dhe</p>

	<p>prezantime të përgjithshme lidhur me vijat kryesore të zhvillimit të së drejtës dhe lidhur me burimet juridike. Në këtë drejtim, theksi i lëndës qëndron në rolin e mësimit të së drejtës romake si disiplinë përgatitëse për njohje kreative të së drejtës civile bashkëkohore. Prandaj, kujdes i veçantë i kushtohet të drejtës pronësore, e cila është bazë për sistemet bashkëkohore juridike të shteteve të Evropës kontinentale dhe teorinë juridike, ndërsa përmbajtjet tjera i përshtaten këtij qëllimi.</p>
--	---

Metodologjia për realizimin e temave mësimore:		
Ligjërata, ushtrime, qasje interaktive , konsultime, punime seminarike.		
Kushtet për realizimin e temës mësimore:		
Literatura adekuate, përdorimi i mjeteve të TI.		
Mënyra e vlerësimit të studentit (në%)		
	Vlerësimi në %	Nota përfundimtare
	Deri në 10 pikë dhe këto pikë vlerësohen në totalin e pikëve nga kollokviumi dhe testi përfundimtarë.	51-60%-nota 6 61-70 7 71-80 8 81-90 9 91-100 10
Kolokiumi Testues jo vlerësues	50% të pikëve të mundshme +1 pikë kollokviumi konsiderohet i suksesshëm dhe pikët nga ky kollokvium u shtohen pikëve nga provimi përfundimtarë	
Testi përfundimtarë për provim	50% të pikëve të mundshme +1 pikë provimi vlerësohet pozitivë. Këtyre pikëve u shtohen pikët nga punimi seminarik dhe nga kollokviumi për të nxjerrë vlerësimin përfundimtarë	
	Vijueshmëria e rregullt e ligjëratave	Maksimal 5%
	Aktiviteti në ushtrime Maksimal	10%
Obligimet e studentit:		
Ligjërata	Ushtrime	
Studenti duhet të jetë i rregullt në ligjërata dhe	Studenti duhet të jetë aktiv në ushtrime dhe të reflektoj gatishmëri dhe dije për iniciativa, ide dhe	

ushtrime ,të shfrytëzoj të gjitha mundësitë për nxënie të dijes,të përdorë literaturën e obliguar dhe më të gjërë,të jetë aktiv dhe të respektoj rregullat mbi shkollimin e lartë të etikës në mirësjellje dhe për bashkëpunim.	demonstrim të njohurive të marra në ligjërata.		
Ngarkesa e studentit për lëndën			
Aktiviteti	Orë	Ditë/Javë	Gjithsej:
Ligjërata	3	15 javë	30 orë
Ushtrime			
Punë praktike			
Kontakte me mësimdhënësin/konsultime	0,5	15 javë	7.5 orë
Ushtrime në terren			
Seminare	0.5	15 javë	7.5
Detyra të shtëpisë			
Koha e studimit vetanak	3	15 javë	45
Përgatitja përfundimtare për provim	3	15 Javë	45
Koha e kaluar në vlerësim(teste,kuize,provim final)			
Projekte,prezantime..etj			
Vërejtje: 1 ECTS kredi=25 orë angazhim,p.sh nëse lënda i ka 6 ECTS kredi student duhet të ketë angazhim gjatë semestrit 150 orë		Ngarkesa totale:	150

Java	Ligjërata	Ushtrime
1.	Tema	Orët
	Hyrje: Vështrim i përgjithshëm i shtetit dhe të drejtës romake. Rëndësia dhe ndikimi i së drejtës romake. Periodizimi dhe ndarja e së drejtës private romake.	3
		Pyetje për diskutim
		2
2.	Tema	Orët
	Burimet e së drejtës romake: ne periudhen arkaike, ne kohene republikes, burimet e ligjit gjate Perandoris, epoka postklasike dhe kodifikimi i Justinianit.	3
		Pyetje për diskutim
		2
3.	Tema	Orët
	E drejta statusore: Subjektet e së drejtës. Zotësia juridike dhe zotësia për të vepruar. Fitimi, përmbajtja, kufizimi dhe humbja e zotësisë juridike. Zotësia e veprimit të personave fizik. Personat juridik	3
		Prezantime, perseritje etj.
		2

4.	E drejta familjare: Familja romake, pozita juridike e anëtarëve të familjes. E drejta martesore: Kushtet për lidhjen e martesës. Pengesat për lidhjen e martesës, fejesa, Format për lidhjen e martesës, marrëdhëniet personale dhe pronësore mes bashkëshortëve. Zgjidhja e martesës. Tutoria dhe kujdestaria. Llojet e tutorisë dhe kujdestarisë.	3	Familja Romake dhe krahasimi me te drejten familjare te diteve tona	2
5.	E drejta reale I: Nocioni mbi sendet. Marrëdhëniet realo-juridike. Llojet e sendeve. Kuptimi i pronës private dhe përmbajtja e saj. Kufizimet. Llojet e pronës private.	3	Krahasim me te drejten reale te diteve te sotit	2
6.	E drejta reale II: Mënyrat e fitimit të pronësisë. Mjetet juridike për mbrojtjen e pronësisë. Humbja e pronësisë. Posedimi. Mbrojtja e posedimit	3	Pronesia Romake: fitimi, humbja, posedimi etj. krahasim me atë të ditëve të otit	2
7.	Kolokiumi i Parë	1	Kolokiumi i parë	2
8.	E drejta reale III: Të drejtat reale mbi sendet e huaja. Servituti. Pengu.	3	Servituti, llojet etj, krahasim dhe studim ne kohë	2
9.	E drejta detyrimore I: Marrëdhëniet e detyrimeve. Subjektet e marrëdhënieve detyrimore. Përfaqësimi. Ndërrimi i subjekteve. Përmbajtja e marrëdhënieve detyrimore.	3	Marrdhëniet detyrimore Romake dhe ato te sotit, krahasime empirike	2

10.	E drejta detyrimore II: Burimet e detyrimeve. Kontrata si burim detyrimesh. Elementet esenciale. Shprehja e akorduar e vullnetit. Mospërputhja mes shprehjes dhe vullnetit të palëve. Forma e kontratave. Elementet jo esenciale. Pavlefshmëria e kontratave. Klasifikimi i kontratave.	3	Kontratat dhe zhvillimi ne kohë, nga Romaket deri më sotë	2
11.	E drejta detyrimore III: Kontratat: Huaja, huapërdorja, depozita, shitblerja, qiraja, kontrata në vepër	3	Pyetje për diskutim, interaktivitet	2
12.	E drejta detyrimore IV: Sigurimi i aktiveve. Sigurimi real dhe ai personal. Deliktet si burime detyrimesh. Shuarja e detyrimeve. Pasojat e moskryerjes së detyrimeve.	3	Prezentime dhe perseritje	2
13.	E drejta trashëgimore: Marrëdhëniet trashëgimore-juridike. Mënyrat e thirrjes në trashëgim. E drejta e domosdoshme e trashëgimit. Fitimi i trashëgimit. Testamenti.	3	Trashegimia nga Romaket deri me sot, krahasime ...	2
14.	Kuptimi dhe krijimi i procedurës civile. Procedura Legis actio, Organet e Procedurës legjisaktore. Procedura in jure dhe pud judicem. Aktgjykimi, anulimi i aktgjykimit, Ekzekutimi i aktgjykimit. Mjetet e jashtëzakonshme për mbrojtjen e të drejtave subjektive, Interdiktet. Procedura Ekstraordinare.	3	Procedura civile Romake dhe krahasimi me atë të sotmen	2
15.		3	Konsultime për provim	2

LITERATURA

Literatura kryesore:

- Asllan Bilalli, Bedri Bahtiri, E Drejta Romake, Prishtine, 2015
- Kadri Kryeziu, E Drejta Romake (Ligjerata te Autorizuara), Prizren, 2015
- Ivo Puhan & Mirjana Polenak - Akimovska, Rimsko pravo, Skopje, 1996.
- Arta Mando, E Drejta Romake, Tiran 2011.

Literatura e avansuar:

- Borkowski&DuPlesis, E Drejta Romake, (Perkthyer nga Guri Daco), Tirane 2000.
- Arta Mandro, E drejta romake, Tiranë, 1998
- Barry Nicholas, An Introduction to Roman Law, Oxford, 1975
- Andrew Borkowski & Paul du Plessis, Textbook on Roman Law, Oxford, 2005.
- HF Jolowicz & Barry Nicholas, A Historical Introduction to the Study of Roman Law, 3rd ed., Cambridge, 2008.
- Marijan Horvat, Rimsko pravo, Zagreb, 2007.
- Ante Romac, Rimsko pravo, Zagreb, 2007.
- Ante Romac, Izvori rimskog prava, Zagreb, 1973

VËREJTJE

Vërejtje për studentin: